



## KËSHILLI KOORDINUES I DIASPORËS

06 Prill 2020

Si KKD jemi duke ndjekur me kujdes situatën e paprecedentë të krijuar nga COVID-19 dhe jemi plotësisht të angazhuar me Komunitetin Shqiptar në vendet ku jetojmë në mënyrë që kjo situatë të kalojë sa më lehtë dhe me sa më pak pasoja.

Sa i përket shtetasve shqiptarë që duan të kthehen në vendlindje, kemi komunikuar me qeverinë e cila na ka konfirmuar angazhimin e saj. Jemi të informuar se deri tani janë riatdhesuar të gjitha rastet emergjente.

Me shqetësim po ndjekim situatën e krijuar për shtetasit shqiptarë në pikat kufitare me Greqinë. I kemi kërkuar shtetit shqiptar që të marrë masa urgjente dhe t'ua lejojë hyrjen në territorin shqiptar bashkëkombësve të bllokuar në zonën neutrale të kufirit me Greqinë si dhe për të evituar një transmetim të mundshëm të virusit, të siguroj qëndrimin e tyre në izolim për një periudhë prej 14 ditësh brenda territorit të Shqipërisë. Për këtë, i kemi ofruar qeverisë shqiptare ndihmën tonë në mënyrë që kjo situatë të marri zgjidhjen e duhur sa më shpejt.

Në kushtet që ndodhemi, i bëjmë apel të gjithë bashkëkombasve tanë që përpara se të vendosin për t'u kthyer në Shqipëri, të mirëinformohen pranë selive diplomatike apo Njësisë së Emergjencës së Ministrisë së Punëve të Jashtme, informacionet e të cilës janë dhënë në faqen zyrtare:

<https://punetejashtme.gov.al/numrat-e-emergjences-ne-mepj-dhe-te-perfaqesive-se-rsh-se-ne-bote>

KKD bën thirrje që situata të tilla të mirëmenaxhohen nga konsullatat dhe ambasadat e shtetit shqiptar duke i mirëinformuar dhe iu qëndruar më pranë shtetasve tanë.

Si KKD jemi totalisht të përkushtuar të ndihmojmë jo vetëm bashkëkombasit tanë, por edhe të kontribuojmë në menaxhimin e kësaj situatë të vështirë në vendlindje. Për këtë arsye jemi në kontakt me qeverinë në mënyrë që të gjejmë mekanizmat më efikas për arritjen e këtij qëllimi.



Kjo situatë e paprecedentë është sfidë për të gjitha shtetet, jo vetëm Shqipërinë, prandaj inkurajojmë të gjithë që t'a përkrahim njëri-tjetrin brenda mundësive në kapërcimin sa më të lehtë të situatës.